



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i shkallës së parë në përbërje prej: Metë Çeku – kryetar, Avni Shala dhe Donat Lushaku – anëtarë, *duke u mbështetur në nenin 63, nenin 66, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika f), të Statutit të FFK-së, si dhe nenit 8, paragrafi 2, pika d), nenit 60, paragrafi 1, pika f) nën 3, nenit 91, dhe 92, pika b) të Rregullores Disiplinore të FFK-së, nenit 51, paragrafi 1, dhe nenit 53 të Propozicioneve të Garave 2023/2024*, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.04.2024 në ora 14:00 shqyrtoi procedurën e inicuar disiplinore të Komisionit të Garave të datës 11.04.2024 ndaj Agon Pira, Zyrtar i KF “Ulpiana 1926” për kurdisje të rezultatit në ndeshjen e rregullt të xhiros së XXI-të Raiffeisen Liga e Parë (Grupi B) të zhvilluar në mes të KF “Ulpiana 1926” nga Lipjani dhe KF “Vllaznia (P)” nga Pozherani-Viti, merrë këtë:

V E N D I M

Agon Pira - Zyrtar i KF “Vllaznia (P)” nga Pozherani-Viti me Nr.ID: 024546M85, për marrëveshje në kurdisje të rezultatit **DËNOHET** me ndalesë të kryerjes së të gjitha funksioneve zyrtare në klub në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, për të gjitha ndeshjet zyrtare vijuese të organizuara nga FFK.

A r s y e t i m

Më datë 07.04.2024 me fillim nga ora 15:00 është zhvilluar ndeshja kampionale (xhiro XXI) e Raiffeisen Liga e Parë (Grupi B) në mes të KF “Ulpiana 1926” Lipjan dhe KF “Vllaznia - Pozheran” nga Pozherani, Viti në Stadiumin “Sami Kelmendi” në Lipjan. Rezultati final u përfundua me shifrat 3:4 në favor të ekipit mysafir.

Me datë 11 prill 2024, Komisioni i Garave i Supërligës dhe Ligës së Parë ka nxjerr Vendim, përmes të cilit ka anuluar sipas detyrës zyrtare ndeshjen Raiffeisen Liga e Parë e zhvilluar ndërmjet KF Ulpiana-KF Vllaznia Pozheran java 21 e përfunduar me rezultat 3:4 në favor të KF Vllaznia (P), dhe e njëjta është regjistruar si ndeshje e luajtur dhe rezultati i saj nuk regjistrohet, po ashtu pikët dhe golët e shënuara nuk do regjistrohen në tabelën e klasifikimit, për arsye se Komisioni. Përmes të njëjtit vendim konform dispozitave të akteve normative të FFK-së , është iniciuar procedura disiplinore ndaj të gjithë personave të përfshirë në këtë ndeshje.

Konform Vendimit të lartcekur, Komisioni i Garave i Supërligës dhe Ligës së Parë ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj personit zyrtar të KF Vllaznia Agon Pira me numër të ID-së 024546M85. Pas inicimit të procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor dhe i Etikës pati në dispozicion prova të ofruara nga zyrtarët kompetent të FFK-së lidhur me ndeshjen KF “Ulpiana 1926” dhe KF “Vllaznia (P)”. Bazuar në gjitha provat materiale si dhe të dhënave të tjera konfidenciale, është vërtetuar fakti se i njëjti ka bërë shkelje të rënda të Statutit dhe të Rregulloreve të FFK-së.



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

Andaj konform të lartcekurave, Komisioni vendosi sikurse në dispozitiv të këtij Vendimi mbi shqiptimin e masës disiplinore ndaj zyrtarit të klubit *të involvuar në marrëveshje për kurdisje të rezultatit të ndeshjes*, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Prishtinë, 19.04.2024

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës - shkalla e parë

Kryetar: Metë Çeku

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese drejtuar Komisionit Disiplinor të shkallës së dytë - Komisionit të Apelit, në afatin kohor prej 8 (tetë) ditësh nga data e pranimin, publikimit të vendimit në faqen zyrtare të FFK-së. Ankesa e ushtruar nga ana e palës së ankimuar nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.